



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 gusht 2016
Ref. no.: 971/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI46/16

Parashtrues

Gradimir Jovanović dhe të tjerët

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-14-0318 - A0001, të 15 tetorit 2015

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gradimir Jovanović, Trajan Jovanović, Slobodanka Jovanović, Gojko Jovanović, Dragan Jovanović, Ljubiša Jovanović, Olivera Jovanović, Gordana Jovanović, Ljiljana Jovanović, Dejan Jovanović dhe Miloš Jovanović (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës) nga Prishtina, të përfaqësuar nga Živojin G. Jokanović, avokat me seli në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), AC-I-14-0318- A0001, të 15 tetorit 2015, në lidhje me Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar), SCC-08-0151, të 16 shtatorit 2014 dhe Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar, AC-10-0063, të 29 nëntorit 2011.
3. Aktvendimi i Kolegjit të Apelit, AC-I-14-0318- A0001, i 15 tetorit 2015, i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës më 31 tetor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me pretendimin se është cenuar neni 102, paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
5. Gjykata vëren se thelbi i kërkesës ngre pretendime për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës në pronë.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 3 mars 2016, parashtruesit nëpërmjet postës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 13 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan, Almiro Rodrigues dhe Selvete Gërxhaliu - Krasniqi.
9. Më 28 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme).
10. Më 17 maj 2016, Dhoma e Posaçme solli dëshmi për datën e pranimit të aktvendimit të kontestuar nga përfaqësuesi i parashtruesve.
11. Më 14 qershor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 16 maj 2008, parashtruesit paraqitën ankesë në Dhomën e Posaçme duke kërkuar kthimin e tokës, që sipas tyre, ka qenë pronë e njërit prej paraardhësve të tyre C. J. Parashtruesit kishin theksuar se toka e tyre ishte marrë nga ndërmarrjet shoqërore: KBI “Kosova – Export” – “Lavërtaria dhe Blegtoria” dhe “Victoria Invest International LLC” (në tekstin e mëtejme: NSH-të) pa pëlqimin e tyre.
13. Më 27 janar 2010, parashtruesit i propozuan Dhomës së Posaçme caktimin e masës së përkohshme, me pretendimin se prona e kontestuar ishte privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), dhe se pronari i ri ka filluar punët ndërtimore në ato ngastra dhe që ata nga kjo do të pësojnë dëme të pariparueshme nëse nuk caktohet masa e përkohshme.
14. Më 9 mars 2010, Kolegji i Specializuar urdhëroi parashtruesit që ta sqarojnë dhe plotësojnë padinë e tyre.
15. Më 2 prill 2010, parashtruesit u përgjigjën në urdhër duke theksuar se padia dhe plotësimi i padisë kanë të bëjnë me kthimin e tokës dhe kundërshtimin e procesit të privatizimit nga AKP-ja.
16. Në ndërkohë, palët kundërshtare përkatësisht ndërmarrjet shoqërore në fjalë i kishin dorëzuar parashtruesit të tyre tek Dhoma e Posaçme përkitazi me padinë e parashtruesve.
17. Më 27 gusht 2010, Kolegji i Specializuar me Aktvendimin SCC-08-0151, kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesve për vënien e masës së përkohshme.
18. Parashtruesit paraqitën ankesë dhe kërkuan nga Kolegji i Apelit që të prish aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar, si dhe të miratojë propozimin për vënien e masës së përkohshme.
19. Më 29 nëntor 2011, Kolegji i Apelit me Aktvendimin ASC-10-0063, konstatoi se ankesa në aspektin procedural ishte e lejueshme porse në themelësi e saj ishte e pabazuar. Kolegji i Apelit konstatoi se kërkesa për vënien e masës së përkohshme ishte po ashtu e pabazuar.
20. Ndërkohë, parashtruesit paraqitën sërish padi tek Kolegji i Specializuar duke ngritur pretendime, ndër të tjera, për pronësinë e tyre ndaj paluajtshmërisë së kontestuar dhe për të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm. Parashtruesit nuk e përsëritën kërkesën e tyre për vënien e masës së përkohshme ndaj pronës së kontestuar.
21. Më 16 shtator 2014, Kolegji i Specializuar me Aktvendimin SCC-08-0151, e hodhi poshtë si të papranueshme padinë e parashtruesve. Kolegji i Specializuar, ndër të tjera, arsyetoi se parashtruesit qëllimisht kanë zvarritur procedurat duke kërkuar shtyrjen e seancave, nuk kanë precizuar kërkesëpadinë e tyre dhe

se atyre u është mundësuar paraqitja e argumenteve dhe fakteve në dobi të tyre, në mënyrë të barabartë me palët kundërshtare gjatë gjithë procedurave.

22. Parashtruesit paraqitën ankesë kundër aktvendimit të lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar.
23. Më 10 tetor 2015, Kolegji i Apelit me Aktvendimin, AC-I-14-0318-A0001, refuzoi ankesat e parashtruesve si të pabazuara dhe vërtetoi Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar. Kolegji i Apelit miratoi arsyetimin e Kolegjit të Specializuar duke konstatuar, ndër të tjera, se parashtruesit nuk kanë precizuar kërkesëpadinë e tyre, kanë zvarritur qëllimisht procedurat dhe se parimi i barazisë së palëve ishte respektuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë si në vijim: *“Sipas mendimit të palës paditëse, Gjykata e shkallës së parë e ka shkelur të drejtën kushtetuese të paditësve në mënyrë që është në kundërshtim me nenin 102, para. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në vend që t’i respektojë të drejtat e paditësve të garantuara me dispozitat e nenit 3.2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 160.4 dhe 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pa baza, me konstatime paushalle, në vend të aktgjykimit me aktvendim, pas 6 (gjashtë) vjetëve prej se ka filluar procedura, ka gjetur se padia është e papranueshme”.*
25. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“... Lëshimet janë bërë në ndërlikimin procedural të marrëdhënieve të pazgjidhura, ashtu që gjithnjë është zgjeruar kërkesa dhe është kërkuar nga paditësit që të përcaktohet numri i paditësve, të cilët po lajmërohen si trashëgimtar pas paraardhësve ligjor, e këtë, mund të thuhet, Gjykata e shkallës së parë e ka bërë në mënyrë tendencioze, që të evitohet vendimi meritor. Përveç asaj, nga ana e paditësve është propozuar që me anë të inspektimit, me pjesëmarrje të ekspertëve të gjeodezisë, të përcaktohet cila pjesë e pronës është e lirë dhe mund t’i kthehet paditësve, sepse një pjesë veç ka qenë e përfshirë me ndërtim në një procedurë të çuditshme. Karakteristike është se ngastrat në të cilat paditësit pretendojnë, sepse ato janë të trashëguara nga babai dhe gjyshi, janë tjetërsuar për 37,00 € për ari, dhe së blerësi i privilegjuar të njëjtën tokë e ka shitur për 20.000 – 30.000 € për ari. Për këtë nuk duhet koment”.*

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata po ashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

29. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullat 27 (3) (4) dhe 36 (1) (c) të Rregullores së punës, që specifikojnë:

*“Rregulli 27
Llogaritja e periudhës kohore*

Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore të punës, llogaritet si më poshtë:

(...)

(3) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;

(4) Kur periudha shprehet në muaj dhe në ditë, së pari llogariten muajt e plotë e pastaj ditët;

*Rregulli 36
Kriteret e pranueshmërisë*

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit”.

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesve më 31 tetor 2015 derisa kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 3 mars 2016, çka tregon se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit ligjor 4 (katër) mujor.

31. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005 dhe po ashtu, shih rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

32. Përveç kësaj, Gjykata dëshiron të theksojë se afati ligjor 4 (katër) mujor llogaritet nga dita kur avokati i parashtruesve ka pranuar vendimin e kontestuar (pas shterimit të mjeteve juridike), pavarësisht nga fakti se

parashtruesit mund ta kenë pranuar të njëjtin vendim të kontestuar më vonë. (Shih, për shembull, rastin *Hatip Çelik kundër Turqisë*, GJEDNJ, aplikacioni nr. 52991/99, Aktvendim i 23 shtatorit 2004).

33. Gjykata thekson se është detyrë e parashtruesve të kërkesave apo përfaqësuesve të tyre që të veprojnë me 'kujdes të nevojshëm' për t'u siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore janë dorëzuar brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës. (Shih rastin *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, [DHM], aplikacionet nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykimi i 17 shtatorit 2014, paragrafët 263-267).
34. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të shpallet e papranueshme për shqyrtim për shkak se është e paafatshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 14 qershor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi